

*E përkthyer nga gjuha maqedone

KOMPONENTËT

Ndihma do të programohet dhe zbatohet në përputhje me komponentët e mëposhtëm:

I Ndihma për Tranzicion dhe ndërtimi i institucioneve;

II Bashkëpunimi Ndërkufitar;

III Zhvillimi Rajonal;

IV Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, dhe

V Bujqësia dhe Zhvillimi Rural.

Komponenti i Ndhmës për Tranzicion dhe Ndërtimi i Institucioneve dhe Komponenti i Bashkëpunimit Ndërkufitar, do të jenë në dispozicion të të gjitha vendeve përfituese, me qëllim që t'i ndihmojë ato në proceset e tyre të tranzicionit dhe në përafrimin e tyre me BE-në, si dhe të nxisë bashkëpunimin rajonal midis tyre.

Komponentët e zhvillimit rajonal, zhvillimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit rural janë në dispozicion vetëm për vendet kandidate të akredituara për menaxhim të decentralizuar të fondeve, për t'i ndihmuar ato të përgatiten për periudhën pas anëtarësimit, në veçanti për zbatimin e politikave të kohezionit dhe zhvillimit rural të Komunitetit, d.m.th. për përdorimin e mjeteve nga Fondi i Kohezionit, Fondi Social Evropian dhe Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (EAFRD).

Komponenti i zhvillimit rural mbështet vendet kandidate për anëtarësim në BE në zhvillimin e politikave, si dhe në përgatitjen për zbatimin dhe menaxhimin e politikës së përbashkët bujqësore të Komunitetit..